



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË

Rrëshen me, 02/07/ 2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“Furnizim dhe montim i impianteve fotovoltaike për vetëkonsum-18 objekte, Bashkia
Mirditë”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Panele diellore
-09331000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 38 377 555 (Tridhjetë e tetë milion e treqind e shtatëdhjetë e shtatë
mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) Lekë pa Tvsh, financuar nga Bashkimi Evropian në kuader të
programit IPA II Shqiperi-Kosove (**Monedha**) **pa TVSH, dhe 408 141.6** (Katërqind e tetë mijë e
njëqind e dyzet e një pikë 6) **Euro Pa TVSH.**

Kursi I këmbimit sipas Bankës së Shqiperisë me datë **01.07.2026**, me kurs këmbimi **94.03**
(Nëntëdhjetë e katër pikë zero tre) **euro.**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 6 javë

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik”,autoriteti kontraktor Bashkia Mirditë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe

miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Kërkesa për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar neni 83 pika 1 si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 30 pika 1.

Këto kritere janë vendosur për të vërtetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte. Gjithashtu këto kritere janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Kjo pikë e kritereve plotësohet me Kriteret e përgjithshme të pranimit/ vecanta të kualifikimit të plotësuar më sipër. (Shtojcat).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar dhe kerkohet nje operator ekonomik i cili te kete minimumin e kerkuar duke marrë ne konsiderate objektin e kontrates.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës **31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Sa me siper, Njesia e Prokurimit duke mbajtur në konsideratë parashikimet ligjore të sipercituara dhe afatin që parashikohet për publikimin e kontrates, vendosi që të kerkojë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, meqenese operatorët ekonomikë kanë afat dorezimi të deklaratës vjetore të vitit 2025 deri më 31 mars 2026. Kjo kerkese e NJ.P vjen me qëllim për tu dhënë mundësi të gjithë operatorëve ekonomikë për pjesëmarrje të cilet mund të mos kenë dorëzuar deklaratën vjetore në organet tatimore për vitin 2025.

2.2.2 Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2025.

Shenim: Kjo kerkese përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43, nenin 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nëni 3.1/a, b, c dhe nëni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrorjnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 si dhe kestet e maturuara të vitit 2025, në zbatim të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit sipas shtojcës 10 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43 pika 6 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar nëni 4 pika 2/d.Referuar sa

më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’ju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Vendorsja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.2.4 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të kenë të punësuar të paktën 20 (njet) punonjës për periudhën Tetor 2025-Dhjetor 2025, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Tetor 2025-Dhjetor 2025**.

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Tetor 2025-Dhjetor 2025**.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, shkronja b dhe c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (nje) mjet transporti me kapacitet mbajtes deri në 3.5 ton, në pronësi, me qira ose kontrate bashkepunimi për transportin e mallrave deri në vendin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

- Per te provuar disponimin e mjeteve te kerkuara, OE duhet te paraqese:

a) Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, siguracion, taksa, pronësia).

b) Per te konfirmuar disponibilitetin e mjetit te marre me qira ose kontrate bashkepunimi, krahas dokumentacionit te mesiperme duhet te paraqiten edhe Kontrate e qirase/ Kontrate Bashkepunimi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar

duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi/qera ose kontrate bashkepunimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar mallrave sipas preventivit dhe specifikimeve teknike. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.2.6 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/ distributorin e autorizuar per mallrat sipas tabelës se mëposhtem:

Nr.	Emertimi
1	Panel fotovoltaik 1 cope
2	Kabull DC 1 ml
3	Inverter Solar
4	Automat sigurie AC/DC
5	Pompe termike
6	Struktura Mbajtëse

Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar, për materialet e sipercituara.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “*Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

- a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
- b) *fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Sa me siper shfaqet e nevojshme që për mallrat objekt prokurimi, të paraqiten Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produktit me specifikimet teknike dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor sigurohet mbi origjinalitetin e mallit.

Në lidhje me këto kritere NJ.P. gjykon se janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me artikullin e kërkuar.

Akoma më tej NJ.P. gjykon se dokumentat e kërkuar Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar, raport analizat mund të sigurohen lehtësisht nga operatorët ekonomikë të cilët kanë për objekt të veprimtarisë së tyre furnizimin me këto kategori produkte. Po ashtu me këto kritere të vendosur, autoriteti kontraktor nuk ka tejkalluar objektin e prokurimit pasi për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet “mall”, sipas standardeve të kërkuara, specifikimeve teknike.

2.2.7 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalog/fragment katalogu/skeda teknike për mallrat sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emertimi
1	Panel fotovoltaik 1 cope
2	Kabull DC 1 ml
3	Inverte Solar
4	Automat sigurie AC/DC
5	Pomper Termike
6	Pajisje për matjen e eficiencës

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, dhe nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se:

-40/6 “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

-40/8 “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Sa me sipër shfaqet e nevojshme që për mallrat objekt prokurimi, të paraqiten katalog/frsgment katalogu/skeda teknike, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produktit me specifikimet teknike.

Në lidhje me këto kritere NJ.P. gjykon se janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me artikullin e kërkuar.

Akoma më tej NJ.P. gjykon se dokumentat e kërkuar katalog/fragment katalogu/skeda teknike mund të sigurohen lehtësisht nga operatorët ekonomikë të cilët kanë për objekt të veprimtarisë së tyre furnizimin me këto kategori produktesh për të cilat kanë për detyrë të dëshmojnë në çdo rast origjinalitetin e tyre dhe të dhenat teknike për këto produkte.

2.2.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të gjithë sasisë së mallit të përfshirë në këtë procedurë prokurimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurimet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

2.2.9 Ditën dhe orën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Nga 1 (një) mostër për secilin nga artikujt e mëposhtëm:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Panel fotovoltai 1 cope	cope	1
2	Kabull DC 1 ml	ml	1
3	Inverte Solar	Cope	1
4	Automat sigurie AC/DC	cope	2
5	Pajisje për matjen e tokezimit	cope	1
6	Pajisje për matjen e efciences	Cope	1

Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave sipas DST-se, pranë magazines së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të Bashkisë Rreshen.

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.

- Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, dhe nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: “Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. 38 Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit”

Ne lidhje me kërkesën për paraqitjen e mostrave Autoriteti Kontraktor thekson se për mostra janë perzgjedhur disa nga mallrat me të rendesishme bazuar në vlerën e produktit, sasitë me të larta, si dhe në përdorimin e tyre pasi ndikojnë ndricimin e rrugeve dhe shikueshmerine tyre në oret e nates.

Theksojmë se Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar qartë adresën dhe oren e paraqitjes së mostrave për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme në Energjinë të kryera gjatë tre viteve të fundit ku vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.1 Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Per kontratat e realizuar si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatoreve të deklaruara në fazën e tenderimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe në nenin 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.**Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:** Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës shërbimeve të

ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021 i ndryshuar, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se shërbimet e mëparshme të ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (pika a dhe b të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e shërbimeve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.2 Licence ne projektim 10 c,d,e, dhe Licence ne Zbatim NP10, NP11, NS 13, NS14

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku AK mund të kërkojë licenca profesionale për realizimin e shërbimeve objekt i kontratës të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Në kuadër të zbatimit për punimet e impiantit PV, është e nevojshme që të kriteret e prokurimit, shoqëria duhet të disponojë licencë të vlefshme në zbatimin e punimeve, konkretisht pika NP-10.

Arsyeja e vendosjes se kriterit mbi disponimin e licencës në zbatim është nga nevoja e llojit të punimeve që do të kryhen pasi në objekt kemi të bëjmë me rikonstruksion metalik të strukturës mbajtëse të paneleve si dhe të inverterave, punime elektrike në anën DC të impiantit, si dhe mirëmbajtja e impiantit në vazhdimësi.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të sigurojë stafin si më poshtë të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licensë profesionale individuale, CV dhe të listuar në listpagesat e Shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës:

1. Menaxher Projekti

Inxhineir i kualifikuar, me diplomë Master Shkencor/ Doktorature në Fushën e Energjise/Efiçencës së Rinovueshme.

Minimumi 5 vite përvojë profesionale në projekte të energjisë fotovoltaike që lidhen me projektimin, dhe zbatim.

Të paktën 5 vite përvojë në projektim dhe zbatim sistemeve fotovoltaike.

Të ketë përvojë të provuar në menaxhimin ose mbikëqyrjen e projekteve për zbatimin e masave të energjisë fotovoltaike, me një vlerë totale prej të paktën 50 % te projektit. Kjo përvojë duhet të vërtetohet me kontrata, certifikata pranimi ose dokumente të ngjashme.

2. Specialist SCADA i Certifikuar

Specialist i certifikuar SCADA: ky specialist është kërkuar pasi Impiantet PV janë të pajisur me sisteme SCADA për monitorim dhe kontroll në kohë reale. Për rrjedhojë specialisti i certifikuar për sistemet SCADA është i nevojshëm për: Integrimin e inverterave të rinj në qendrën e kontroll-monitorimit, konfigurimin e komunikimeve dhe softuerit të monitorimit, diagnozën e problemeve të telemetrisë dhe automatizimit. Pra garantohet mbikëqyrja e vazhdueshme e performancës së impiantit.

3. Inxhinier Elektrik te punesuar

Referuar kërkesave të paraqitura në termat e referencave inxhinieri elektrik është thelbësor për analizimin dhe projektimin e impianteve elektrike. Siguron që instalimet të jenë sipas standardeve të sigurisë (IEC/EN), do të kryejë mbikëqyrjen dhe riparimet në inverter, kabllime DC/AC, sistemet e mbrojtjes dhe pajisjet e shpërndarjes së energjisë. Gjithashtu inxhinieri elektrik është i nevojshëm për diagnostikimin e defekteve elektrike, dhe do të jetë pjesë ndihmëse në testimin dhe kolaudimin e impiantit para vënies në punë

4. Inxhinier Mekanik per sistemet e kondicionimit te punesuar

Referuar kërkesave të paraqitura në termat e referencave inxhinieri mekanik do të kujdeset për strukturat mbajtëse të paneleve, montimin e paneleve si dhe elementët mekanikë të fiksimit. Siguron stabilitetin e impiantit ndaj ngarkesave të erës, reshjeve, apo faktorëve të tjerë mekanikë. Gjithashtu gjatë mirëmbajtjes, kontrollon korrozionin, fiksimit dhe integritetin e bazamenteve.

5. Teknik Kondicionimi

Referuar kërkesave të paraqitura në termat e referencave tekniku I kondicionimit do të kujdeset për koordinimin e punimeve në ambientet ku ndodhen pajisje për kondicionim dhe ventilim, verifikimin dhe shmangien e ndërhyrjeve që mund të ndikojnë në funksionimin e sistemeve ekzistuese të kondicionimit gjatë kalimit të kabllave, sigurimin e ventilimit dhe kushteve të përshtatshme teknike për pajisjet.

6. Teknik Hidraulike – kerkohet për realizimin dhe rikthimin e hidroizolimeve dhe elementeve të kullimit në çati gjatë vendosjes së strukturave mbajtëse; ndërhyrjet ndihmëse në rrjetet e ujërave dhe elementët e drenazhimit që mund të preken nga punimet e montimit; garantimin që instalimi i impiantit të mos cenojë funksionimin normal të sistemit të kullimit të objektit.

7. Specialist për sigurinë dhe shëndetin në punë (HSE).Referuar kërkesave të AK-së të paraqitura në termat e referencave specialisti për sigurinë dhe shëndetin në punë është i domosdoshëm për të garantuar që punimet kryhen në kusht sigurie, sidomos pasi kemi të bëjmë me energji elektrike në tension dhe punë në lartësi. Gjithashtu harton dhe zbaton planin e menaxhimit të rreziqeve gjatë riparimeve dhe mirëmbajtjes si dhe Siguron pajisjet mbrojtëse personale (PPE) dhe trajnimin e stafit.

Nëse operatori ekonomik është bashkim shoqërisht, licencat mund të plotësohen në grup.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.4. Çertifikatat e cilesise dhe Standartet

Kontraktori duhet të zotëroje çertifikatat si më poshtë:

EN ISO 9001:2015 – Quality Management System

EN ISO 14001:2015 – Environmental Management

EN ISO 45001:2018 – Occupational Health and Safety Management

ISO 50001:2018 – Energy Management System

HSE- Certifikate per ndihmen e pare

ISO 9001: “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” - Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 45001: “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” - Ky standart është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

ISO 50001- “Sistemi i menaxhimit të energjisë” – Ky standard është i nevojshëm për stimulimin e kontraktorëve për të gjetur mënyra në identifikimin e mundësive për të reduktuar konsumin e energjisë, duke konsideruar përfshirjen e stafit në këtë proces

ISO 14001 – “Sistemi i menaxhimit të mjedisit” – Ky standard është i nevojshëm për stimulimin e kontraktorëve për të gjetur mënyra në identifikimin e mundësive për të reduktuar ndikimin mjedisor dhe konsumin e burimeve natyrore, duke konsideruar përfshirjen e stafit në këtë proces.

Argumentimi:

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

2.3.5 Kontarata te ngjashme ne sektorin publik apo privat mbi 500 KWP për kontratë

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe në nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Objekti i kontratës konsiston në projektimin, furnizimin, instalimin, testimin dhe vënien në punë të një impianti fotovoltaiik me kapacitet të konsiderueshëm. Për këtë arsye kërkohet që operatori ekonomik të ketë realizuar më parë kontrata të ngjashme me kapacitet jo më të vogël se **500 kWp**, pasi realizimi i impianteve të kësaj madhësie kërkon njohuri teknike, organizim të punimeve, koordinim të proceseve të instalimit dhe përvojë në testimin e sistemeve fotovoltaike.

Kjo kërkesë është në përputhje me objektin e kontratës dhe synon të garantojë që operatori ekonomik disponon eksperiencën e nevojshme për realizimin me sukses të investimit.

2.3.6 Eksperience te meparshme me projekte Internacionale si:

- a. Banka Boterore,
- b. UNDP
- c. EU

Argumentim: Projektet e financuara nga institucionet ndërkombëtare karakterizohen nga standarde të larta teknike, procedura të rrepta të kontrollit të cilësisë dhe kërkesa të avancuara për administrimin e kontratës. Përvoja në projekte të tilla tregon aftësinë e operatorit ekonomik për të respektuar standarde ndërkombëtare të projektimit, instalimit dhe raportimit.

Për të mos kufizuar konkurrencën, kërkesa pranon edhe projekte të financuara nga institucione të tjera financiare ndërkombëtare ose donatorë me standarde të ngjashme.

2.3.7 Pajisje per matjen e tokëzimit DY4100

Argumentim: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar, dhe nenit 40, pika 5 dhe 8, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Pas përfundimit të instalimit të impiantit fotovoltaiik është i domosdoshëm verifikimi i sistemit të tokëzimit, pasi ai është element thelbësor për sigurinë elektrike të impiantit.

Për këtë arsye operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje për matjen e rezistencës së tokëzimit, si **DY4100 ose ekuivalente**, e aftë të kryejë matje sipas standardeve përkatëse.

2.3.8 Pajisje per matjen e fuqise se paneleve dhe testimit te tyre PVPM 1000C40

Argumentim: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar, dhe nenit 40, pika 5 dhe 8, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Përpara marrjes në dorëzim të impiantit duhet të kryhen testet e performancës së moduleve dhe stringjeve fotovoltaike. Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje për testimin e karakteristikave elektrike të moduleve fotovoltaike, si **PVPM 1000C40** ose ekuivalente, e cila mundëson matjen e

kurbës I-V, fuqisë reale të moduleve dhe verifikimin e performancës së impiantit në përputhje me parametrat teknikë të projektit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP (e ndryshuar), si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(e ndryshuar), duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. (bashkëlidhur dst)

Anëtarët e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të Autoritetit Kontraktor nr.312 date 18.06.2026, kanë rënë dakort për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **“Furnizim dhe montim i impianteve fotovoltaike për vetëkonsum-18 objekte, Bashkia Mirditë”**, me vlerë: **38 377 555** (Tridhjetë e tetë milion e treqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) Lekë pa Tvsh, financuar nga Bashkimi Evropian në kuader të programit IPA II Shqiperi-Kosove. Iloji i procedurës: **E hapur mbi kufirin e lartë monetar - Mallra**

Specialistët e fushës, kanë hartuar kërkesat për kualifikim lidhur me kapacitetin teknik (pika 4 e nenit 74 të Vkm-së nr.285, datë 19.05.2021, e ndryshuar). Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kritereve.

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do ti paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për t’u firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJESIA E PROKURIMIT